

Master i shkencave në „Përkthim teknik-letrar dhe Interpretim”

Viti I

Semestri I

Përkthim B-A

Titullari / pedagogu i lëndës: Dr. Erta Spaho-Herri

Ngarkesa: 6 kredite; 60 orë mësimore; 15 leksione / 45 seminare

Tipologjia e lëndës:

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: 2021-2022 / Semestri I Viti I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: “Master i shkencave” në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: erta.spaho@[unitir.edu.al](mailto:erta.spaho@unitir.edu.al)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Lënda “Përkthim B-A” është një lëndë e karakterit kryesisht praktik. Në të do të trajtohet përkthimi i teksteve të ndryshëm duke sqaruar ndërkohë dhe në mënyrë të përmbledhur teknikat që përdoren për përkthimin e llojeve të ndryshme të teksteve.

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Ky kurs synon të sistemojë në mënyrë profesionale përvojat që studentët kanë përfituar gjatë studimeve të mëparshme, ose në praktike të rastësishme. Studentët do të pajisen me mekanizmat e nevojshëm logjikë e teknikë në kombinimet gjuhësore B-A. Në studentët e nivelit të dytë kërkohet të konsolidohen edhe reflekset redaktuese e korrektuese krahas atyre të përkthimit. Studentët duhet të përmirësojnë aftësitë e tyre në fushën e përkthimit. Sigurisht që lënda do ndihmojë edhe në rritjen dhe përmirësimin e njohurive gjuhësore të studentëve, por njëkohësisht edhe në zgjerimin e formimit të tyre të përgjithshëm.

Objektivat specifike lëndore:

Ky kurs do të ndihmojë studentët: të konsolidojnë aftësitë e tyre përkthyes, e do jenë në gjendje të realizojnë përkthimet e tyre.

PERKTHIM A-B Moduli 1

Titullari / pedagogu i lëndës: Dr. Sonila SADIKAJ

Ngarkesa: 3 kredite; 30 orë mësimore; 30 seminare

Tipologjia e lëndës:

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti I / Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master shkencor në “Përkthim teknik-letrar dhe Interpretim”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:
sonila.sadikaj@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Të stërviten studentët e ciklit të dytë në nivel më të lartë, duke konsoliduar reflektet përvetësuese të kuptimit dhe ato përkthyesore, si edhe ato redaktuese e korrektuese. Të përmirësojnë shpejtësinë dhe cilësinë në përkthim e teksteve paralettrare. Studentët do të zhvillojnë shprehitë e nevojshme të analizës, përpunimit, vlerësimit dhe paraqitjes së informacionit në gjuhën e përkthimit për një komunikim ndër-gjuhësor dhe ndërkulturor të përshtatshëm, në kombinimin gjuhësor A-B

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Ky kurs synon t’u mprehë studentëve shikimin përsa u përket vështirësive që hasen në përkthimin e teksteve të zhanreve të ndryshme (politike, shoqërore, kulturore, turistike, filologjike, etj.), me qëllim që ata të jenë të aftë që pas një analize të mirëfilltë shumëplanëshe (pragmatike, leksikore dhe terminologjike, gramatikore dhe stilistikore) të zhvillojnë strategji në nivel mikro dhe makro për të sintetizuar tekstin në gjuhën mbërritëse, duke njohur karakteristikat specifike të këtyre teksteve.

Në përfundim të kursit studentët do jenë të aftë t’u përgjigjen sfidave që parashtron përkthimi i teksteve të sipërpërmendura. Ata do të dinë të përdorin hap pas hapi instrumentet e duhura në të përditshmen profesionale.

Objektivat specifike lëndore:

Ushtrime të natyrës praktike, ku studentët diskutojnë mbi variantet e ndryshme të përkthimit të termave të çdo fushe nga tekste dhe materiale nga gazetatat e revistat e

ndryshme. Bëjnë ushtrime të ndryshme duke zgjeruar fjalorin e tyre në këto fusha. Përkthim tekstesh nga fushat e sipërpërmendura (tekste paraletrare). Analizë, përkthim terminologjie, sintetizim i tekstit në gjuhën mbërritëse, redaktim në nivel përmbajtjeje, në nivel gjuhësor dhe nivel stilistikor.

Gjuhë C 1

Titullari /pedagogu i lëndës: Dr. Migena Sejdini

Ngarkesa: 3 kredite; 30 orë mësimore; 30 seminare;

Tipologjia e lëndës: C

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti I/Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: “Master i shkencave” në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:
migena.sejdini@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Ky kurs synon t'i bëjë të aftë studentët të kuptojnë informacione kryesore në biseda për tema të njohura për ta si puna, banesa, koha e lirë, arsimi etj. Ata do të jenë në gjendje të përballojnë situatat e përditshme, të shprehin me shkrim dhe me gojë mendimet e tyre mbi tema të ndryshme, të kërkojnë informacione në lidhje me punësimin dhe studimin, të raportojnë për ngjarje dhe skperiencat e tyre të përshkruajnë qëllimet dhe objektivat si dhe të argumentojnë dhe shprehin për tema të ndryshme.

Objektivat specifike lëndore: Në fund të këtij kursi studenti do të jetë i aftë:

- të zotërojë fjalorin e duhur për temat e lartpërmendura;
- të forcojë rregullat dhe konceptet;
- të përdorë gjuhën në mënyrë të pavarur;
- të lëvizë në një ambjent gjermanishtfolës pa patur nevojë për një ndërmjetës gjuhësor;
- të njohë më nga afër kulturën gjermane.

Përkthim C-A

Titullari / pedagogu i lëndës: Dr. Erta Spaho-Herri

Ngarkesa: 6 kredite; 60 orë mësimore; 15 leksione / 45 seminare

Tipologjia e lëndës:

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: 2021-2022 / Semestri I Viti I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: “Master i shkencave” në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: erta.spaho@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Lënda “Përkthim C-A” është një lëndë e karakterit kryesisht praktik. Në të do të trajtohet përkthimi i teksteve të ndryshëm duke sqaruar ndërkohë dhe në mënyrë të përmbledhur teknikat që përdoren për përkthimin e llojeve të ndryshme të teksteve.

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Ky kurs synon të sistemojë në mënyrë profesionale përvojat që studentët kanë përfituar gjatë studimeve të mëparshme, ose në praktike të rastësishme. Studentët do të pajisen me mekanizmat e nevojshëm logjikë e teknikë në kombinimet gjuhësore C-A. Në studentët e nivelit të dytë kërkohet të konsolidohen edhe reflekset redaktuese e korrektuese krahas atyre të përkthimit. Studentët duhet të përmirësojnë aftësitë e tyre në fushën e përkthimit. Sigurisht që lënda do ndihmojë edhe në rritjen dhe përmirësimin e njohurive gjuhësore të studentëve, por njëkohësisht edhe në zgjerimin e formimit të tyre të përgjithshëm.

Objektivat specifike lëndore:

Ky kurs do të ndihmojë studentët: të konsolidojnë aftësitë e tyre përkthyes, e do jenë në gjendje të realizojnë përkthimet e tyre.

Përkthim terminologjik

Titullari / pedagogu i lëndës: Dr. Ergys Prifti

Ngarkesa: 3 kredite; 30 orë mësimore; 15 leksione / 15 seminare

Tipologjia e lëndës:

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: 2021-2022 / Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje

Programi i studimit: Master Shkencor

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: ergys.prifti@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Programi përmban trajtimin e temave që lidhen me përkthimin terminologjik nga gjuha gjermane në gjuhën shqipe dhe anasjelltas. Studentët do të trajtojnë tekste me terminologji nga fusha të ndryshme si nga fusha juridike, mjekësore, ekonomike, nga terminologjia e Bashkimit European etj.

Objektivat e përgjithshme lëndore:

- Të arrijë të marrë njohuritë bazë të përkthimit terminologjik
- Të njohë teknikat e nevojshme për studimin e tematikës së lëndës
- Të mësojë të kërkojë dhe të organizojë e sistemojë informacionin gjuhësor të lëndës

Objektivat specifike lëndore:

- Të mësojë të planifikojë punën sipas etapave të caktuara
- Të analizojë dhe të formojë një gjykim personal, të arsyeshëm dhe aktiv mbi burimet e ndryshme dhe literaturën e shfrytëzuar.
- Të analizojë rastet e paraqitura
- Të punojë në mënyrë të pavarur me fjalorë dhe leksikonë një- dhe dygjuhësh
- Të dokumentojë punën e kryer
- Të referojë e të bëjë të njohur rezultatet e kërkimit të tij.

Metodologji e perkthimit

TEKNIKA TË REDAKTIMIT DHE TË SHPREHJES

Titullari /pedagogu i lëndës: Dr. Maklena Çabej, Prof.asoc. Leonard Xhamani

Ngarkesa: 6 kredite, 20 leksion dhe 40 seminare

Tipologjia e lëndës: B

Viti akademik/semestri kur zhvillohet: 2021-2022 / semestri I

Lloji i lëndës: e detyrueshme

Programi i studimit: “Master i shkencave” në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:
maklene2000@yahoo.com, leonardxhemani@hotmail.com

PËRSHKRIMI I LËNDËS

Lënda *Teknika të redaktimit dhe të shprehjes* ka në thelb të përmbajtjes së saj njohjen nga ana teorike dhe praktike të procesit të redaktimit. Redaktimi është procesi i përzgjedhjes dhe i përgatitjes së një pune të shkruar para publikimit apo botimit. Kjo lëndë synon të njohë studentët me këtë proces, sidomos nga ana praktike, që të jenë në gjendje të kryejnë pa dëmtuar dhe kur është e nevojshme ndryshime objektive thelbësore, strukturore dhe stilistike, në mënyrë që puna e shkruar të paraqitet e saktë për botim sipas normave të gjuhës shqipe.

a) Ana kuptimore (semantika):

1. Keqinterpretimi, pakuptueshmëria, kundërkuptimet, harresat e fjalive, frazave.

2. Përkthim i gabuar i një fjale; shtesa/heqje që dëmtojnë kuptimin; mungesë përpikërie (kur bëhet fjalë për termat); ngjyrimë të gabuara të fjalëve.

b) Ana gjuhësore (sintaksa):

1. Strukturë e gabuar ose e huazuar nga teksti bazë që nuk i përgjigjet shqipes.

2. Gabime gramatikore, ambiguitete (kuptime të dyfishta kur këto nuk i ka origjinali); përsëritje të panevojshme; huazime të panevojshme.

c) Ana stilistikore:

Ruajtja e stilit të autorit e të përkthyesit. Mosndërhyrje për të ruajtur individualitetin.

OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Studenti duhet:

të përsosë njohuritë në gramatikën e gjuhës shqipe, sidomos në strukturën e saj të thellojë njohuritë në leksikun e gjuhës shqipe.

të arrijë kompetencat e të kuptuarit dhe të argumentuarit për ndryshimet themelore që i duhen bërë një teksti para botimit.

të punojë në mënyrë të pavarur.

Viti I

Semestri II

PËRKTHIM B-A

Titullari / pedagogu i lëndës: Dr. Erta Spaho-Herri

Ngarkesa: 6 kredite; 60 orë mësimore; 20 leksione / 40 seminare

Tipologjia e lëndës:

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: 2021-2022 / Semestri II Viti I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: “Master i shkencave” në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: erta.spaho@[unitir.edu.al](mailto:erta.spaho@unitir.edu.al)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Lënda “Përkthim B-A” është një lëndë e karakterit kryesisht praktik. Në të do të trajtohet përkthimi i teksteve të ndryshëm teknik duke sqaruar ndërkohë dhe në mënyrë të përmbledhur teknikat që përdoren për përkthimin e llojeve të ndryshme të teksteve.

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Ky kurs synon të sistemojë në mënyrë profesionale përvojat që studentët kanë përfituar gjatë studimeve të mëparshme, ose në praktike të rastësishme. Studentët

do të pajisen me mekanizmat e nevojshëm logjikë e teknikë në kombinimet gjuhësore B-A. Në studentët e nivelit të dytë kërkohet të konsolidohen edhe reflekset redaktuese e korrektuese krahas atyre të përkthimit. Studentët duhet të përmirësojnë aftësitë e tyre në fushën e përkthimit. Sigurisht që lënda do ndihmojë edhe në rritjen dhe përmirësimin e njohurive gjuhësore të studentëve, por njëkohësisht edhe në zgjerimin e formimit të tyre të përgjithshëm.

Objektivat specifike lëndore:

Ky kurs do të ndihmojë studentët: të konsolidojnë aftësitë e tyre përkthyes, e do jenë në gjendje të realizojnë përkthimet e tyre.

Perkthim A-B Moduli 2

Titullari / pedagogu i lëndës: Dr. Sonila SADIKAJ

Ngarkesa: 3 kredite; 30 orë mësimore; 30 seminare

Tipologjia e lëndës:

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti I / Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master shkencor në “Përkthim teknik-letrar dhe Interpretim”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:
sonila.sadikaj@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Të stërviten studentët e ciklit të dytë në nivel më të lartë, duke konsoliduar reflekset përvetësuese të kuptimit dhe ato përkthyesore, si edhe ato redaktuese e korrektuese. Të përmirësojnë shpejtësinë dhe cilësinë në perkthim e teksteve paraletrare. Studentët do të zhvillojnë shprehitë e nevojshme të analizës, përpunimit, vlerësimit dhe paraqitjes së informacionit në gjuhën e përkthimit për një komunikim ndër-gjuhësor dhe ndërkulturor të përshtatshëm, ne kombinimin gjuhesor A-B

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Ky kurs synon t’u mprehë studentëve shikimin përsa u përket vështirësive që hasen në përkthimin e teksteve të zhanreve të ndryshme (politike, shoqërore, kulturore,

turistike, filologjike, etj.), me qëllim që ata të jenë të aftë që pas një analize të mirëfilltë shumëplanëshe (pragmatike, leksikore dhe terminologjike, gramatikore dhe stilistikore) të zhvillojnë strategji në nivel mikro dhe makro për të sintetizuar tekstin në gjuhën mbërritëse, duke njohur karakteristikat specifike të këtyre teksteve.

Në përfundim të kursit studentët do jenë të aftë t'u përgjigjen sfidave që parashtron përkthimi i teksteve të sipërpërmendura. Ata do të dinë të përdorin hap pas hapi instrumentet e duhura në të përditshmen profesionale.

Objektivat specifike lëndore:

Ushtrime të natyrës praktike, ku studentët diskutojnë mbi variantet e ndryshme të përkthimit të termave të çdo fushe nga tekste dhe materiale nga gazetat e revistat e ndryshme. Bëjnë ushtrime të ndryshme duke zgjeruar fjalorin e tyre në këto fusha. Përkthim tekstesh nga fushat e sipërpërmendura (tekste paraletrare). Analizë, përkthim terminologjie, sintetizim i tekstit në gjuhën mbërritëse, redaktim në nivel përmbajtjeje, në nivel gjuhësor dhe nivel stilistikor.

PËRKTHIM C-A

Titullari / pedagogu i lëndës: Dr. Erta Spaho-Herri

Ngarkesa: 6 kredite; 60 orë mësimore; 20 leksione / 40 seminare

Tipologjia e lëndës:

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: 2021-2022 / Semestri II Viti I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: “Master i shkencave” në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: erta.spaho@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Lënda “Përkthim C-A” është një lëndë e karakterit kryesisht praktik. Në të do të trajtohet përkthimi i teksteve të ndryshëm teknik duke sqaruar ndërkohë dhe në mënyrë të përmbledhur teknikat që përdoren për përkthimin e llojeve të ndryshme të teksteve.

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Ky kurs synon të sistemojë në mënyrë profesionale përvojat që studentët kanë

përfituar gjatë studimeve të mëparshme, ose në praktike të rastësishme. Studentët do të pajisen me mekanizmat e nevojshëm logjikë e teknikë në kombinimet gjuhësore C-A. Në studentët e nivelit të dytë kërkohet të konsolidohen edhe reflekset redaktuese e korrektuese krahas atyre të përkthimit. Studentët duhet të përmirësojnë aftësitë e tyre në fushën e përkthimit. Sigurisht që lënda do ndihmojë edhe në rritjen dhe përmirësimin e njohurive gjuhësore të studentëve, por njëkohësisht edhe në zgjerimin e formimit të tyre të përgjithshëm.

Objektivat specifike lëndore:

Ky kurs do të ndihmojë studentët: të konsolidojnë aftësitë e tyre përkthyes, e do jenë në gjendje të realizojnë përkthimet e tyre.

PERKTHIM A-C

Emërtimi i lëndës: Përkthim A-C

Titullari / pedagogu i lëndës: Dr. Ergys Prifti

Gjuha: Gjermanisht

Ngarkesa: 3 ECTS, 30 orë seminar

Viti akademik: 2020 - 2021

Lloji i lëndës: lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master

Viti: i parë

Adresa elektronike e titullarit / e pedagogut të lëndës: [ergys.prifti@untir.edu .al](mailto:ergys.prifti@untir.edu.al)

Kodi i etikës:

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Kjo është një lëndë e detyrueshme dhe me karakter hyrës dhe praktik që do t'i japë studentit njohuri të përgjithshme mbi fushën e përkthimit. Rezultatet e pritshme të të nxënit për studentët janë:

- Të arrijë të marrë njohuritë bazë të përkthimit
- Të njohë teknikat e nevojshme për studimin e tematikës së lëndës
- Të mësojë të kërkojë dhe të organizojë e sistemojë informacionin gjuhësor të lëndës
- Të mësojë të planifikojë punën sipas etapave të caktuara
- Të analizojë dhe të formojë një gjykim personal, të arsyeshëm dhe aktiv mbi burimet e ndryshme dhe literaturën e shfrytëzuar.
- Analizojë rastet e paraqitura
- të punojë në mënyrë të pavarur me fjalorë dhe leksikonë një- dhe

dygjuhësh

- të dokumentojë punën e kryer
- të referojë e të bëjë të njohur rezultatet e kërkimit të tij.

Metodologji e kërkimit dhe mjeteve të përkthimit

Titullari / pedagogu i lëndës: Dr. Sonila SADIKAJ

Ngarkesa: 30 kredite; 30 orë mësimore; 15 leksione / 15 seminare

Tipologjia e lëndës:

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti I/ Semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje

Programi i studimit: Master shkencor në “Përkthim teknik-letrar dhe Interpretim”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:
sonila.sadikaj@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Studentet njihen në rrafsh teorik e praktik me burimet kryesore elektronike që shërbejnë si instrumente të nevojshme në të gjitha fazat e procesit të përkthimit, që nga analiza e tekstit burimor dhe përcaktimi i tipologjisë së tij e deri tek produktioni/sintetizimi dhe redaktimi final i tekstit në gjuhën mbërritëse. Ata pajisen në përfundim të kursit me një aparat ndihmës të mjeteve dhe instrumenteve elektronike më të përdorshme në praktikën përkthimore.

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Studentet njihen me fjalorët dixhitalë online dhe fjalorët në medime të tjera elektronike përcjell internetit, me glosarët terminologjikë online. Njihen me bazat elektronike të të dhënave për terminologjinë e fushave të ndryshme.

Mësojnë të punojnë me tekste paralele dhe mbi të gjitha “ku” dhe “si” ti gjejnë apo filtrojnë në internet tekstet paralele.

Bëhet një përjasje mes përkthimit human dhe atij automatik dhe u mësohet studentëve si të shfrytëzojnë sistemet elektronike të përkthimit automatik (Translation Memory Systems).

Ata njihen me instrumentet elektronike të redaktimit të tekstit dhe me kompetencat e përpunimit elektronik të tij.

Objektivat specifike lëndore:

- Studenti aftësohet më tej në përkthimin e teksteve të zhanreve të ndryshme dhe pasuron terminologjinë e tij në fushat përkatëse.
- Studenti zgjeron njohuritë aktive dhe pasive të gjuhës gjermane, kryesisht leksikun terminologjik.
- Studenti zgjeron dhe elaboron kreativitetin për sa i takon punës kërkimore në përkthim
- Studenti mëson të rrisë shpejtësinë e përkthimit duke përdorur instrumentet dhe teknikat e duhura, dhe duke shfrytëzuar sistemet e përkthimit automatik (Translation Memory Systems).

Teknika të redaktimit dhe të shprehjes

Titullari /pedagogu i lëndës: Prof. As. Dr. Ema Kristo

Ngarkesa: 3 kredite; 30 orë mësimore; 30 seminare;

Tipologjia e lëndës:

Viti akademik 2021-2022/Semestri kur zhvillohet: Viti I/Semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në “Gjuhë Gjermane”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: ema.kristo@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Redaktimi përfshin disa njohuri dhe aftësi specifike (shenjat e redaktimit, teknikat e leximit editorial, llojet e redaktimit etj.).

Studenti duhet:

- të përsosë njohuritë në gramatikën e gjuhës gjermane, si dhe të gjuhës shqipe, sidomos në strukturën e tyre
- të thellojë njohuritë në leksikun e gjuhës gjermane dhe të gjuhës shqipe
- të arrijë kompetencat e të kuptuarit dhe të argumentuarit për ndryshimet themelore që i duhen bërë një teksti para botimit
- të punojë në mënyrë të pavarur
- të thellojë aftësinë për të arritur lidhjen midis formës dhe përmbajtjes së

veprës, saktësinë e përdorimit të materialit faktik, përmirësimin e strukturës kompozicionale, qartësinë logjike, hartimin kompetent leksikor leksikor të tekstit

Objektivat specifike lëndore:

Studenti duhet:

- të njohë nga ana teorike e praktike procesin e redaktimit në gjuhën gjermane ose tekste të përkthyer në gjuhën shqipe, duke i krahasuar me origjinalin në gjermanisht.
- Të korrigjojë tekstin e shkruar, të eliminojë gabimet drejtshkrimore, të korrigjojë pikësimin, etj. Të jetë i aftë të bëjë ndryshime në hartimin e dokumentit (ndryshimi i fontit, dhëmbëzimit dhe parametrave të tjerë teknikë të tekstit, ndarja në kolona).
- Të jetë në gjendje të kryejë pa dëmtuar dhe kur është e nevojshme ndryshime objektive thelbësore, strukturore dhe stilistike në tekste para procesit të shtypshkrimit.
- Të jetë i aftë të përgatitë një punë të plotë redaktoriale për procesin e mëtutjeshëm të shtypshkrimit.

GJUHË E HUAJ C (2)

(Formati sipas VKM nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL)

Titullari /pedagogu i lëndës: Ma. Evis Vasili

Ngarkesa: 6 kredite, 60 orë seminar,

Tipologjia e lëndës: D

Viti akademik: 2021-2022 viti i parë, semestri i dytë

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master shkencor në “Perkthim teknik-letrar dhe Interpretim”

Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike: evisvasili@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Studenti duhet të jetë i aftë të kalojë nga një nivel më i ulët në nivelin pasardhës më të lartë në zotërimin e gjuhës gjermane. Studentët duhet të aftësohen në shprehinë e të folurit, të shkruarit, të lexuarit dhe dëgjuarit në gjuhën gjermane. Lënda synon zotërimin praktik të gjuhës së shkruar gjermane, pajisjen e studentëve

me aftësitë dhe shprehinë komunikative bazë (leximi, dëgjim, të folur, shkrim) brenda disa tematikave të njohura dhe mbi bazën e materialit leksiko-gramatikor të përvetësuar. Studenti duhet të jetë i aftë të:

- Të zgjerojë leksikun
- Të perfeksionojë njohuritë gramatikore dhe ti zotërojë rregullat gramatikore në praktikë gjatë të folurit
- Të përmirësojë aftësinë e të kuptuarit të teksteve të folura, pra të rrisë aftësinë dëgjimore-kuptimore dhe ti praktikojë ato me anë të të folurit.
- Të përmirësojë aftësinë e të shprehurit me gojë, aftësinë e argumentimit.

Objektivat specifike lëndore:

Kjo është një lëndë e detyrueshme në kurrikulën e degës së Gjuhës Angleze dhe Franceze, e cila zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të parë me 60 orë seminare. Lënda ka karakter praktik (me shpjegimet respektive teorike të titullarit) dhe u shërben studentëve për të përmirësuar aftësitë dhe kompetencat e tyre gjuhësore në aspektin praktik në të katërta shprehinë në bazë të nivelit me të cilin ata hyjnë në vitin e parë. Në përfundim të secilit modul, studentin duhet të ketë kapërcyer një nivel (B2).

Viti II

Semestri I

Metodologji e Interpretimit

Interpretim B-A / A-B

Titullari /pedagogu i lëndës: Dr. Erta Spaho –Herri, M.A. Ilda Themeli

Ngarkesa: 10 kredite; 100 orë mësimore; 15 leksione/85 seminare;

Tipologjia e lëndës:

Viti akademik: 2021 - 2022/semestri II

Lloji i lëndës: e detyrueshme

Programi i studimit: “Master shkencor në Përkthim Letrar, Pragmatik dhe Interpretim”

Adresa elektronike: erta.spaho@unitir.edu.al ilda.themeli@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Kjo lëndë synon thellimin e njohurive të përfuara në ciklin e parë të studimeve në lidhje me nocionet bazë të interpretimit, veçoritë e interpretimit konsektiv dhe simultan, njohjen dhe të kuptuarit e situatës përkthimore si dhe ushtrimin e aftësive pjesore të të dëgjuarit, të analizuarit e të prodhuarit gjuhësor me qëllim realizimin e komunikimit ndërgjuhësor në kombinimin B - A dhe A – B. Gjuha B është gjuha e parë e huaj nga e cila dhe drejt të cilës realizohet interpretimi (në kuptimin e këtij programi gjuhë B konsiderohet gjuha gjermane). Gjuha A është gjuha amtare (në kuptimin e këtij programi gjuhë A konsiderohet gjuha shqipe.

Objektivat specifike lëndore:

- të realizojë me saktësi e plotësi kuptimore interpretimin konsektiv dhe simultan nga gjuha B drejt gjuhës A dhe anasjelltas nga gjuha A drejt gjuhës B duke ruajtur nuancat stilistikore të mesazhit, ato me natyrë prozodike si dhe duke realizuar një interpretim korrekt nga pikëpamja gramatikore

- të realizojë me saktësi e plotësi kuptimore interpretim me përsëritje (chuchotage) nga gjuha B drejt gjuhës A dhe anasjelltas nga gjuha A drejt gjuhës B si formë e veçantë e interpretimit simultan duke ruajtur nuancat stilistikore, ato me natyrë prozodike, duke realizuar një interpretim korrekt nga pikëpamja gramatikore

- Lënda kontribuon në rritjen e kompetencës gjuhësore në gjuhën B si dhe në rritjen e aftësisë së studentëve për punë të pavarur me lloje të ndryshme ligjërimesh.

Kursi do të dominohet nga seancat praktike simuluese të konferencave duke ndjekur vijën e progresionit pedagogjik. Sa i përket tematikave të interpretimit konsektiv dhe simultan do të përzgjidhen një larmi temash konferencash, të përshtatura për nga shkalla e vështirësisë terminologjike dhe të ritmit të referimit/kohëzgjatjes së pasazheve për interpretim konsektiv deri në gjashtë minuta sipas qëllimeve konkrete didaktike e metodologjike. Në lidhje me interpretimin simultan do të ndiqet progresioni didaktik duke filluar ushtrimin e kësaj forme të interpretimit me ligjërime të njohura nga ushtrimet e konsektivit, duke vazhduar me simultanin me ritme të ngadalta dhe simultanin me ritme të shpejta. Sa i përket përvetësimit të normave deontologjike kursi do të integrojë lojë me role për ilustrimin e normave dhe diskutim të tyre gjatë interpretimit të studentëve.

Interpretim C-A

Titullari /pedagogu i lëndës: Dr. Erta Spaho –Herri, M.A. Ilda Themeli

Ngarkesa: 8 kredite; 80 orë mësimore; 15 leksione/65 seminare

Tipologjia e lëndës:

Viti akademik: 2021 - 2022/semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: “Master shkencor në Përkthim Letrar, Pragmatik dhe Interpretim

Adresa elektronike: erta.spaho@unitir.edu.al ilda.themeli@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Kjo lëndë synon thellimin e njohurive të përfuara në ciklin e parë të studimeve në lidhje me nocionet bazë të interpretimit, veçoritë e interpretimit konsektiv dhe simultan, njohjen dhe të kuptuarit e situatës përkthimore si dhe ushtrimin e aftësive pjesore të të dëgjuarit, të analizuarit e të prodhuarit gjuhësor me qëllim realizimin e komunikimit ndërgjuhësor në kombinimin C - A. Gjuha C është gjuha e dytë e huaj nga e cila realizohet interpretimi (në kuptimin e këtij programi gjuhë C konsiderohet gjuha gjermane). Gjuha A është gjuha amtare (në kuptimin e këtij programi gjuhë A konsiderohet gjuha shqipe).

Objektivat specifike lëndore:

- të realizojë me saktësi e plotësi kuptimore interpretimin konsektiv dhe simultan nga gjuha C drejt gjuhës A duke ruajtur nuancat stilistikore të mesazhit, ato me natyrë prozodike si dhe duke realizuar një interpretim korrekt nga pikëpamja gramatikore
- të realizojë me saktësi e plotësi kuptimore interpretim me përshpëritje (chuchotage) nga gjuha C drejt gjuhës A si formë e veçantë e interpretimit simultan duke ruajtur nuancat stilistikore, ato me natyrë prozodike, duke realizuar një interpretim korrekt nga pikëpamja gramatikore
- Lënda kontribuon në rritjen e kompetencës gjuhësore në gjuhën C si dhe në rritjen e aftësisë së studentëve për punë të pavarur me lloje të ndryshme ligjërimesh.

Kursi do të dominohet nga seancat praktike simuluese të konferencave duke ndjekur vijën e progresionit pedagogjik. Sa i përket tematikave të interpretimit konsektiv dhe simultan do të përzgjidhen një larmi temash konferencash, të përshtatura për nga shkalla e vështirësisë terminologjike dhe të ritmit të referimit/kohëzgjatjes së pasazheve për interpretim konsektiv deri në gjashtë minuta sipas qëllimeve konkrete didaktike e metodologjike. Në lidhje me interpretimin simultan do të ndiqet progresioni didaktik duke filluar ushtrimin e kësaj forme të interpretimit me ligjërime të njohura nga ushtrimet e konsektivit, duke vazhduar me simultanin me ritme të ngadalta dhe simultanin me ritme të shpejta. Sa i përket përvetësimit të normave deontologjike kursi do të integrojë lojë me role për ilustrimin e normave dhe diskutim të tyre gjatë interpretimit të studentëve.

PËRKTHIM LETRAR

(Formati sipas VKM nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL)

Titullari /pedagogu i lëndës: *Dr. Marsela Likaj*

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 10 leksione/30 seminare

Viti akademik: 2020-21 viti II, Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master në Përkthim-Interpretim

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike: : marsela.likaj@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndore: Ky kurs ka si qëllim të njohë studentët me specifikat e tekstit letrar dhe t'i aftësojë ata në këtë fushë përkthimi.

Objektivat specifikë lëndorë: Ky kurs do të ushtrojë të përkthyerit në gjuhën shqipe të autorëve dhe veprave të ndryshme të letërsisë. Tekstet letrare të përzgjedhura nga periudha të ndryshme vendosen në kontekstin historik dhe shoqëror të kohës dhe analizohen si modele letrare të periudhës që përfaqësojnë. Në fund të këtij kursi studenti do të përvetësojë teknika të përkthimit letrar dhe do të jetë i aftë të përkthejë tekste të zhanreve të ndryshme.

METODOLOGJI E KËRKIMIT SHKENCOR

Titullari /pedagogu i lëndës: Dr. Migena Sejdini

Ngarkesa: 6 kredite; 60 orë mësimore; 30 orë leksione / 30 orë seminare;

Tipologjia e lëndës:

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti II / Semestri III

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave në “Përkthim teknik-letrar dhe Interpretim”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:
migena.sejdini@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Ky kurs i njeh studentët me metodat e punës kërkimore të përdorura në fushën e gjuhësisë së aplikuar dhe në mënyrë të veçantë në kërkimet në gjuhën e huaj duke i pajisur ata me njohuri teorike dhe shprehje praktike për metodat e kërkimit, hartimit dhe përpilimit të një punimi shkencor. Në të trajtohen konceptualizimi dhe kryerja e kërkimit shkencor, parashtrimi i çështjeve të kërkimit, grumbullimi dhe mbledhja e të dhënave, përpunimin dhe analizimi i tyre si dhe shkrimi dhe raportimi i kërkimeve shkencore.

Objektivat specifike lëndore: Ky kurs i njeh studentët me ndryshimet midis kërkimit sasior dhe cilësor, me rolin e kërkuesit, me supozimet e tij për realitetin duke vënë theksin në kërkimet në vendin e punës, në përdorimin e metodave të ndryshme si dhe në procesin e përpilimit dhe shkrimit të punimit dhe përgatitjes së tij për botim. Synimi i këtij kursi është t'i aftësojë studentët për të lexuar dhe analizuar në mënyrë kritike kërkimet shkencore të botuara në fushën e gjuhësisë së aplikuar dhe përkthimit, për të kuptuar fazat e ndryshme të procesit të kryerjes së kërkimit shkencor, për të kuptuar mënyrat e ndryshme si mbledhjen, përshkruhen dhe analizohen të dhënat, për të shkruar një punim shkencor duke përdorur metodat sasore dhe cilësore, për të shkruar punime shkencore, për të dalluar dhe përdorur stilin shkencor, për të cituar dhe për ta përdorur mendimin e huaj në përputhje me rregullat etike të studimeve shkencore.